

Si duhet të veprohet për pacientët të cilët banojnë në qarkun e Durrësit dhe kryejnë dializën në Spitalin Amerikan Durrës, t'u ofrohet shërbim transporti nga spitali, njesoj siç ofrohet edhe në qytetin e Tiranës?

Në zbatim të urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë nr. 469, datë 30.08.2010 “Për sigurimin e transportit për të sëmurët që trajtohen me dializë”, i ndryshuar, përcaktohet se, drejtoria e spitalit e çdo rrethi, në rastin e transportit me automjetet e transportit të shërbimit urban (autobus-furgon), të rimbursojë koston e transportit nga banesa në qendrën e dializës dhe anasjelltas, në masën e tarifave të përcaktuara për funksionimin e shërbimit urban publik, bazuar në biletat e paraqitura, ose vërtetimin e lëshuar nga qendra përkatëse e dializës për numrin e seancave të kryera nga secili i sëmurë, i rrethit të tyre.

Për sa më sipër, rimbursimi i koston të transportit për pacientët që përfitojnë shërbimin e dializës bëhet në masën e tarifave të përcaktuara për funksionimin e shërbimit urban publik të përcaktuara nga institucionet përgjegjëse.

Cilat janë analizat periodike të përfshira në kontratën e shërbimit të hemodializës që kryhen falas për këta pacientë?

Ekzaminimet periodike që kryhen për pacientët dializantë ofrohen në zbatim të urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë nr. 326, datë 19.07.2017, “Për miratimin e protokolleve mjekësore të realizimit të paketave të shërbimeve që financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor” përcaktuar në Aneksin nr. 1 “Paketa e Dializës” pjesë përbërëse e kontratës “Për financimin e paketave të shërbimeve shëndetësore të ofruara nga institucionet shëndetësore jopublike, për vitin 2024”.

link: <https://fsdksh.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/Kontrata-2024-me-Institucionet-Shendetesore-jo-Publike.pdf>

Informacion lidhur me dietën ushqimore për pacientët të cilët janë me diabet

Sqarojmë se dieta ushqimore për pacientët e dializës është hartuar nga dietologu dhe mjeku specialist nefrolog i shërbimit të nefrologji dializës (në QSUNT), të cilët në zbatim të protokollit mjekësor të dializës, gjenden shëndetësore të pacientit si dhe të diagnozave shoqëruese (ku përfshihet dhe diabeti), ndjekin caktimin dhe marrjen e dietës ushqimore të nevojshme të pacientit kur pacienti kryen seancën e dializës.

Një kopje të kontratës së shërbimit të hemodializës.

Në lidhje me kontratën “Për financimin e paketave të shërbimeve shëndetësore të ofruara nga institucionet shëndetësore jopublike, për vitin 2024” ku bën pjesë edhe paketa e shërbimit të dializës, kontrata me institucionet shëndetësore jopublike, gjendet e publikuar në faqen zyrtare të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

link: <https://fsdksh.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/Kontrata-2024-me-Institucionet-Shendetesore-jo-Publike.pdf>